

VENDIM
Nr.450, datë 18.7.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.558, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT, TË
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM, INSPEKTIMIT TË
PËRGJITHSHËM DHE SHIFRËS, NË MINISTRINË E BRENDSHME ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit, SHKB-së, Inspektimit të Përgjithshëm dhe Shifrës, në Ministrinë e Brendshme”, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.558, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit, SH.K.B, Inspektimit të Përgjithshëm dhe Shifrës në Ministrinë e Brendshme

[illegible]